



Ny. 58 prot
Dt. 16/08/2018



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 3 Datë 14. 08. 2018

**“MIRATIM NË PARIM PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR PËR ENERGJI
ELEKTRIKE” SUBJEKTIT “RENEWABLE-ENERGY” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 7 pika 2 ,të nenit 50, pika 2, të ligjit nr.6/2018 për disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.111/2012 dt.15.11.2012 “Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore”, të VKM Nr.416 datë 13.05.2015 si dhe të nenit 24, pika1/ c, të VKM Nr. 822 datë 07.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt konçesioni”, për paisjen me autorizim(miratim ne parim) te subjektit “RENEWABLE-ENERGY” SH.P.K., me propozim të A.B.U Drin- Bunë dhe oponentës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Keshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë,

V e n d o s i:

1-Miratimin në parim të kërkesës së subjektit “**RENEWABLE-ENERGY**” SH.P.K me administrator Z. Artan ÇIRRAGA, për përdorim të burimit ujor, **Përroi i Lepushit**, dege e lumit Zalli i Bulqizës, degë e Lumit Drini i Zi për prodhim energjie elektrike në fshatin Dragoi, Njësia Administrative Fushë Bulqizë, Bashkia Bulqizë, Qarku Dibër .

Sipas studimit të paraqitur nga subjekti, HEC DRAGOI do të ketë këto të dhëna:

Koordinatat e veprës së marrjes : X - 44 36 790 ; Y - 45 99 750 ; Z - + 1045 m

Koordinatat e godinës së centralit: X - 44 37 940 ; Y - 45 98 120 ; Z - + 728 m

Koordinatat e pikes së shkarkimit : X - 44 37 940 ; Y - 45 98 120 ; Z - + 728 m

Prurja mesatare e përroit: Q mes = 0.070 m³/sek;

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti: Q llog = 0.110 m³/sek;

Prurja ekologjike: Q ekol = 0.009 m³/sek;

Prurja që shkarkohet: Q= 0.110 m³/sek.

2- Autorizimi(miratimi ne parim) i përdorimit të burimit ujor për prodhim energjie elektrike jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3- Ngarkohet A.B.U. Drin-Bunë për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Raimonda GURI



KRYETAR

Cesk MILLJA

